**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER LINDITA A. DURMISHAJ**
**ADRESA Rruga "Petro Nini Luarasi"**
**Pall. Gora, Nr. 12, Njësia Administrative**
**Nr. 2, TIRANË**
**TEL: 0682097661**

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 72** **Nr. koleksioni: 31/1**

**Tirane më 17/01/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2022051110003272905

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER LINDITA A. DURMISHAJ**

A2022051110003272905

**Repertori Nr.** 72
**Kolesioni Nr.** 31/1

## KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME
## (Automjeti)

Sot, në datë **17.01.2022**, para meje **Noter Lindita A. Durmishaj**, Anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën: Rr: "Petro Nini Luarasi", Pall. Gora, Njësia Nr. 12, Kati Përdhe, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë u paraqitën personalisht:

## A. PALËT NË KONTRATË

**PALE DHURUESE**
**Fatjon Kalivaçi**, atësia Qemal, amësia Liri, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë, Berat dhe banues në TIRANË, me adresë Pandi Raidhi 03920222; Nd. 5; H. 40; Ap. 12; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 31/07/1989, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034637305 dhe nr. personal I90731055P, leshuar nga MPB ne daten 21.08.2019, i vlefshem deri ne daten 20.08.2029.

**PRANUES I DHURIMIT**:
**Entiliano Sakolli**, atësia Bujar, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Idriz Dollaku; Nd. P.Domus; H. Shk.1; Ap. Ap.21; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 13/01/1990, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033066360 dhe nr. personal J00113062U, leshuar nga MPB ne daten 24.03.2016, i vlefshem deri ne daten 23.03.2026.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 761 e vijues i tij; si edhe ligjit nr. *110/2018 "Për Noterinë"*, neni 62, pika 1, gërma "ll", si dhe nenet 99, 100, 101; si dhe Udhëzimit nr. 232, datë 14.1.2016 "Mbi ndryshimin e Pronësisë së mjeteve rrugore" e vijues bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Dhurimit se 50% = 1 kuote te shoqerise " AUTO – DIDO", sipas kushteve dhe kritereve ligjore të mëposhtme:

### Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",* i ndryshuar
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"

## B. TË DHËNA PËR PRONËSINË
### Te dhena mbi pasurine objekt kontrate

**Palet ne kete kontrate** sikurse dhe vertetohet nga " Ekstrakti Historik i Regjistrit Tregtar per te dhenat e subjektit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar " - " AUTO – DIDO" ( marre on

A2022051110003272905

line nga faqja zyrtare e QKB, ne daten 17.01.2022) jane bashkeortak te shoqerise " AUTO – DIDO" Sh.P.K, me seli ne Tirane , rr: " Ali Demi", Godina 17/2, perballe deges se BKT, kati perdhe, me NUIS M12323007N, me kapital te shoqerise 1.200.000,00 ( njemilion e dyqind mije )leke dhe status te shoqerise aktiv.

## C. OBJEKTI I KONTRATES:

Dhurimi nga ortaku Fatjon Kalivaçi te ortaku Entiliano Sakolli i kuotes se diponueshme nga ortaku Fatjon Kalivaçi, me vlere 600.000( gjashteqind mije) leke, me pjesemarrje 50 % ne kapitalin e shoqerise " AUTO – DIDO" Sh.P.K.

Nga kerkimi i bere nga Regjistri i Barreve Sigueruese, sikurse vertetohet dhe nga Rezultati i Kerkimit te dates 17.01.2022 nuk rezulton qe kuota e zoteruar nga ortaku Fatjon Kalivaçi, me pjesemarrje 50% ne kapitalin e shoqerise, te jete e ngarkuar me barre apo kufizime, pra pala dhuruese eshte e lire te dhuroj kuoten e saj me pjesemarrje 50% te kapitalit te shoqerise " AUTO – DIDO" Sh.P.K, sipas parashikimeve te kesaj kontrate.

Pala dhuruese deklaron se i dhuron pales pranuese te dhurimit pasurine e mesiperme sipas kushteve si me poshte:

## E. KUSHTET E KONTRATES:

*E.1.* Dhuruesi garantoin se eshte pronar i ligjshem i pasurise se luajtshme te pershkruar ne objektin e kesaj kontrate; ai nuk eshte pale ne ndonje konflikt gjyqesor apo administrativ ne proces dhe/ose nuk kercenohen nga fillimi i ndonje procedure gjyqesor apo administrativ kunder tij qe mund te cenoje vleren ose titullin e pronesise mbi pronen objekt kontrate; nuk ka lidhur dhe nuk do te lidh asnje marreveshje qe direkt ose indirekt mund te cenoje te drejtat e pranuesit te dhurimit qe rrjedhin nga kjo kontrate; asnje nga informacionet e dhena nga dhuruesi e te perfshira ne kete pike te kesaj kontrate me te cilat pranuesi i dhurimit eshte paisur apo do te paiset, nuk permban deklarime te paverteta mbi nje fakt te caktuar apo nuk le pa permendur nje fakt te njohur e te nevojshem per t'u deklaruar, sipas rrethanave ne te cilat ato jane bere; dhuruesi pranon se deklarimet dhe garancite e tij sipas kesa pike jane bere me qellim per te shtyre pranuesin e dhurimit te lidhe kete kontrate dhe pranuesi i dhurimit e ka lidhur kete kontrate duke u bazuar dhe konsideruar te mireqena keto garanci.

***E.2.*** Pala dhuruese deklaron se nuk ka asnje pretendim kundrejt pales pranuese te dhurimit persa i perket kesaj kontrate dhe kushteve te saj.

***E.3.*** Palet kane rene dakord qe kjo kontrate dhurimi te mos ngarkohet me asnje lloj kushti apo barre mbi pasurine objekt kontrate.

*E.4.* Me nenshkrimin e kesaj kontrate, pala dhuruese, humbet çdo te drejte pronesie apo cdo te drejte tjeter reale mbi pjesen e tij, me pjesemarrje 50 % te kuotave te kapitalit te shoqerise " AUTO – DIDO" Sh.P.K dhe te drejtat mbi kuoten e pales dhuruese kalojne ne favor te pales pranuese te dhurimit, e cila behet ne kete menyre pronare e vetme e kapitalit 1.200.000,00 ( njemilion e dyqind mije )leke dhe pjesemarrje 100% ne kapitalin e shoqerise.

*E.5.* Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, nje kopje e saj se bashku me dokumentet shoqeruese duhet te paraqitet detyrimisht prane QKB per tu bere ndryshimet perkatese lidhur me ortaket e shoqerise

Kjo Kontratë e redaktuar prej meje në gjuhën shqipe, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të *Palëve,* të cilët më deklaruan se u njohën dhe e kuptuan

A2022051110003272905

përmbajtjen dhe efektet e saj juridike dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALA DHURUESE:** Fatjon Kalivaçi

**PALA PRANUESE E DHURIMIT:** Entiliana Sokolli

Unë Noterja e bindur për identitetin dhe vullnetin e lirë e të pavesuar të palëve si dhe për ligjshmërinë e Aktit, në bazë të nenit 761 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil" (i ndryshuar), Ligjit 110/2018, "PËR NOTERINË, e vërtetoj atë në katër kopje origjinale me vlerë të njëjtë, një prej të cilave arkivohet dhe administrohet në këtë zyrë noteriale, një kopje depozitohet prane QKB për regjistrim dhe nga një kopje u vihet në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

**NOTER**

Lindita Durmishaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE LINDITA A. DURMISHAJ NOTER TIRANË

NUIS: M12323008 Auto DIDO Sh.p.k Tirana - Albania